



## UDHËZIME PËR AUTORËT

Të gjithë autorët janë të ftuar ti regjistrojnë punimet e tyre në përputhje me temat e Kongresit. Mund të regjistrohen punime hulumtuese dhe jo-hulumtuese, si dhe e-poster prezentime (poster elektronik). A do të prezentohet autori në mënyrë orale, apo me e-poster prezentacion, do të vendosi kuvendi shkencor i Kongresit. Abstrakti mund të shkruhet në gjuhën anglishte apo në gjuhën amtare, me fontin "Ariel", me madhësi të shkronjave 12. Abstrakti nuk mund të tejkalojë 300 fjalë. Fjalë kyçe, maksimum 5. Brenda abstraktit duhet të veçohen nëntitujt (Ariel, 12 pikë, bold, rrafshim i majtë).

### **Për punim hulumtues**

Nëse autorët dëshirojnë të regjistrojnë një punim hulumtues, ai duhet ti përmbaje kaptinat në vijim:

**HYRJE** - Duhet të emrohet problemi kryesor dhe qëllimi i hulumtimit.

**MATERIJALI DHE METODAT** - Duhet të përshkruhen karakteristikat kryesore të zbatimit të hulumtimit - modeli dhe mënyra e zgjedhjes së të hulumtuarve, veprimet e vlerësimit, metodat dhe kohëzgjatja e intervenimit.

**REZULTATET** - Duhet të përshkruhen rezultatet kryesore të hulumtimit dhe të regjistrohen matjet e tjera me rëndësi.

**PËRFUNDIM** - Duhet të shënohen përfundimet e përfituara nga hulumtimi, si dhe relevanca klinike e studimit. Njëkohësisht, duhet të shënohen zbulimet pozitive, si dhe ato negative.

**LITERATURA** - Citatet: stili i Vankuverit / Harvardit.

### **PËR PUNIM OBSERVUES**

Nëse autorët dëshirojnë të regjistrojnë punim që nuk përmban punë hulumtuese, ai duhet ti përmbajë këto kaptina:

**HYRJE** - Duhet të emrohet problemi kryesor dhe qëllimi i hulumtimit.

**PËRMBAJTJA** - Rezime tematike që do ti ofrojë lexuesit shiqim preliminar të temës.

**PËRFUNDIMI** - Të jepet përfundim që i konvenon problematikës në fjalë.

**LITERATURA** - Citatet: stili i Vankuverit / Harvardit.

Abstrakti duhet të dorëzohet deri me datën 25.08.2023 me anë të postës elektronike në adresën **kongresskopje2023@gmail.com**. Pasi të pranohet punimi nga ana e kuvendit shkencor, ai do t'ia vërtetojë pranimin autorit të parë, për mënyrën e prezentimit, gjuhën e prezentimit, si dhe ftesës për dërgimin e punimit në përgjithësi, jo më shumë se 10 faqe të formatit A4, me madhësi të fontit Ariel 12, me vend mes vijave (line spacing) prej 1.5. Punimet do të botohen në CD.

Autorët bartin përgjegjësi të plotë për brendinë e punimit. Autorët e punimit e dorëzojnë brendinë e tij kuvendit shkencor pa e botuar të njëjtin në kongrese, takime, ose botime të tjera. Nëse teksti ka qenë i botuar më parë, autorët duhet këtë ta shënojnë në veçanti.

Teksti i punimeve i përket ekskluzivisht autorëve të tij. Gjatë civateve referencijale përdoret stili i Vankuverit. Emrat e autorëve duhet të shkruhen nën titullin e temës, në mes, me emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin dhe vendin (emrin e institucionit) ku punon autori. Nëse anëtarët e kuvendit shkencor vlerësojnë se nevojiten punimedhe spjegime shtesë lidhur me punimin, të gjitha vërejtjet do ti dërgohen autorit të parë. Të gjitha prezentacionet tematike do të kenë kohë të zgjatjes prej maksimum 15 minuta.



### **POSTERI ELEKTRONIK / e-poster**

Posterit elektronik, ose e-posteri, i përngjan posterit tradicional nga letra, i cili nëpërmjet të projektorit prezentohet mbi sipërfaqe të bardhë. E-posteri paraqet një koncept të rij të formës piktorale elektronike që është statike. Ai prezentohet nëpërmjet posterit të përkatitur me anë të programeve grafike (CorelDraw dhe Photoshop). E-posteri mund të prezentohet nëpërmjet USB, DVD/CD, në formën e fotografisë me rezolucion të lartë, JPG ose PDF, font 12, dhe madhësi jo më të madhe se 50mb. Gjatë përpilimit të postrit brenda programeve të lartëpërmendura, madhësia e definuar nuk guxon të tejkalojë 1780 x 1000 piksel. Rezolucioni i mirë i e-posterit mundëson që në mënyrë të lehtë të përcillet informata deri te dëgjuesi. Organizatori e siguron pajisjen e nevojshme për prezentacionin e e-posterit: laptop me sistem operativ Windows 10, si dhe video projektor me rezolucion 1280 x 800.



**CONGRESS 2023**

22-24 September, Skopje

